


AKT THEMELIMI

Sot më datën 06.10.1994, në Tiranë,
ARTAN GAÇI, i biri i Ilias dhe i Valit, lindur më 14.05.1969
në Tiranë e banues po këtu, Rruga "Irfan Tomini", Pall.40, Shk.5,
Ap.61 deklaron se në mbështetje të ligjit Nr.7512, 7632 e 7638
ka vendosur sa vijon:



Neni 1

Të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin shoqëror "GAÇI" SH.P.K. me ortak të vetëm Artan Gaçi.

Neni 2

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, Rruga "Durrësit",
N° 142, përballë Uzinës Tirana.

Neni 3

Shoqëria ka një jetëgjatësi deri në vitin 2010, por duke mos përjashtuar mundësinë e reduktimit apo zgjatjes së afatit të saj, gjithmonë sipas vendimit të ortakut të vetëm.

Neni 4

Shoqëria ka për objekt të aktivitetit të saj:

-Import eksportin e mallrave të ndryshme industriale të lejuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi në të gjithë gamën e llojshmërisë së tyre, përfshirë pjesë këmbini automjeteve të çdo lloji e marke, veshje të ndryshme, artikuj argjendarie si dhe tregtimin e tyre me shumicë e pakicë;

-servis automjeteve të çdo lloji e marke, parking e lavazh automjeteve;

-operacione të ndryshme me pasuri të palujtëshme;

-investime në industri; kryerja e sipërmarrjeve të ndryshme vetë ose në bashkëpunim me persona të tjerë fizikë apo juridikë vendas apo të huaj.

Neni 5

Shoqëria ka një kapital prej 100.000 (njëqindmijë) lekë, të derdhur e të nënshkruar nga ortaku i vetëm e të vertetuar me mandatpagesën përkatëse.

Kapitali themeltar i përket tërësisht ortakut të vetëm Zotit Artan Gaçi.

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 kuota me vlefte nga 1000 (njëmijë) lekë secila.

Neni 6

Viti i parë ushtrimor mbyllet më 31 Dhjetor te vitit 1994. Fitimi i realizuar i përket tërësisht ortakut të vetëm.

Neni 7

Shoqëria administrohet nga një administrator i vetëm edhe pse jo ortak.

Me anë të këtij akti emërohet administrator i vetëm zoti Artan Gaçi.

Neni 8

Shoqëria ka mënyren e strukturën e saj të organizimit, modalitetet e së cilës përcaktohen në statutin e shoqërisë që i bashkëlidhet këtij akti e përbëjne sëbashku një tërësi të vetme të miratuar nga ortaku i vetëm.

Neni 9

Mosmarrveshjet e ndryshme që lindin midis shoqërisë e të tretëve zgjidhen nga Gjykata e Tiranës.

Neni 10

Për çdo gjë që nuk është shprehur në këtë akt vlejné dispozitat e statutit të shoqërisë e në mungesë dispozitat e Kodit Tregtar, Ligjit Për shoqëritë tregtare e ato të Kodit Civil.

ORTAKU I VETEM

Artan Gaçi

